



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUSA BELEDİYESİ – KOMUNA E MAMUSHËS-OPSTINA MAMUSA - MUNICIPALITY OF MAMUSA

STATUTI I KOMUNËS

MAMUSHË, DHJETOR 2008

Në bazë të nenin 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr. **03/L-040**, dhe nenit 74 të Statutit të Përkoħshem tē PNJK-sé Mamushés, nr.01, Kuvendi i Komunés sé Mamushés, në mbledhjen e mbajtur 01.12. 2008, bie këtë :

STATUTI I KOMUNÉS SÉ MAMUSHÉS

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME Pjesa 1

Neni 1

Statuti i Komunés, éshtë akti më i lartë juridik i Komunés që miratohet nga Kuvendi i Komunés, në pajtim me nenin 12 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Statuti rregullon organizimin e brendshém tē komunés. Në përdorimin e mëtutjeshém do të njihet si "Statuti i Komunés".

Neni 2

2.1 Komuna éshtë njësi territoriale-administrative, e Republikës sé Kosovës, në të cilën qytetarët realizojnë vetëqeverisjen lokale në pajtim me dispozitat e Kushtetutén e Republikës sé Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e pushtetit lokal dhe dispozitat e këtij Statuti.

Neni 3

3.1 Ky Statut zbatohet në territorin e komunés tē përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Kufijtë Administrativ tē Komunave.

3.2 Komuna mund tē hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Neni 4

4.1. Komuna éshtë përgjegjëse për udhëheqjen dhe menaxhimin e çështjeve publike në funksion tē sigurimit tē kushteve pér jetë normale pér tē gjithë banorët pa dallim race etnie, gjuhe, religjioni , përcaktimi politik apo mendimi tjeter.

4.2 Komuna éshtë përgjegjëse pér zbatimin e politikave dhe praktikave pér tē mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve, krijimin e kushteve tē përshtatshme pér t'iu mundësuar tē gjitha komuniteteve pér t'i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.

Neni 5

5.1 Komuna éshtë person juridik.

5.2 Selia e komunés éshtë në Mamushé.

Komuna është e bartëse e të drejtës së pronësisë në pronat komunale të të gjitha llojeve (tokës, hapësirës afariste, objekteve të ndryshme, ndërtesave, pyjeve, ujërave, minierave dhe resurseve të tjera) në territorin e Komunës të cilat shfrytëzohen dhe administrohen nga komuna.

Kuvendi i Komunës me vendim do t'i themelojë ndërmarrjet me interes të posaçëm për komunën.

Neni 6

6.1 Qytetar i Komunës është çdo shtetas i Republikës së Kosovës me vendbanim në territorin e Komunës.

Neni 7

7.1 Në komunë, në përdorim zyrtar, janë gjuha turke, gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Neni 8

8.1 Komunën e përbëjnë: qyteza e Mamushës, Zonat kadastrale (Cad. ID No. 71813054), e cili ndahet në 9 lagje urbane dhe një shesh përkatësish si vijon :

8.2 Me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës (në tekstin e mëtejmë Kuvendi), mund të përcaktohen lagje, vendbanime periferike dhe sheshe tjera në territorin e Komunës.

II. Simbolet, vulat dhe festat

Neni 9

9.1 Komuna e ka Emblemen.

Emblema e Komunës është (Përbajtja e Emblemës do të përcaktohet me vendim të veçantë, meqë Emblema ende nuk është miratuar)

9.2 Emblema paraqitet në katër forma :

- a) miniaturale (për distiktivë), në dimisione.....
- b) të vogël, në dimisione.....
- c) të mesme, në dimisione, dhe
- d) të madhe, në dimisione

9.3 Përdorimi i Emblemës është e drejtë ekskluzive e Komunës dhe asnjë subjekt apo person nuk mund ta përdorë Emblemën dhe as shenjat dhe simbolet tjera pa autorizim paraprak nga organi kompetent i Komunës.

9.4 Mënyra e përdorimit të Emblemës përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës (në tekstin e mëtejmë Kuvendi)

Neni 10

10.1 Komuna e ka Flamurin e vet.

10.2 Përbajtja, pamja e drejta dhe mënyra e përdorimit të flamurit përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit .

Neni 11

11.1 Komuna e ka vulën e Rrumbullakët dhe vulën Katrore të Protokollit,

11.2 Vula e Rrumbullakët e ka këtë tekst _____, në mes është emblema e Komunës.

Dimensioni i vulës është _____

11.3 Vula Katrore e Protokollit e ka formën e katërkëndëshit kundrejt me dimensione _____ X _____, me tekstin _____ dhe emblema e Komunës

Neni 12

12. 1 Vulat janë të shkruara në gjuhën turke, gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe.

Neni 13

13.1 Mënyra e përdorimit, mbajtjes dhe ruajtjes së vulave përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit.

Neni 14

14.1 Komuna shënon festat shtetërore, kombëtare, të Komunës përkatësisht festat sipas kalendarit të festave në Republikën e Kosovës

Neni 15

15.1 Komuna i ka festat e veta.

15.2 Dita e Çlirimit të Komunës është data 13 Qershor. (të shkruhet arsyetimi përsë është caktuar kjo datë)

15.3 Dita e festës së Komunës është 27 Shatorin. (arsyetimi)

15.4 Festat e Komunës, të cekura në alinet paraprake të këtij nenit, shënohen me organizimin e seancave solemne të Kuvendit dhe manifestime të ndryshme kulturore e sportive.

Neni 16

16.1 Kuvendi ndan shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.

16.2 Vlera maksimale e shpërblimeve në mjete financiare është në shumën prej 100.00 €.

16.3 Kuvendi, në raste të veçanta, mund të merr vendim për shumë më të lartë se në alinenë paraprake të këtij nenit.

16.4 Me vendim të veçantë të Kuvendit, përcaktohen kushtet dhe mënyrat e dhënies së shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve.

III. Kompetencat dhe fushë veprimtaritë e Komunës

Neni 17

Komuna i ushtron kompetencat vetanake, dhe të deleguara në përputhje me dispozita ligjore dhe akte nënligjore mbi bazën e parimit të subsidiaritetit.

Kompetencat vetanake

Neni 18

Komuna në pajtim me Statutin, ushtron:

- Miraton programet e zhvillimit të veprimtarive komunale;
- Ofron dhe siguron kushte themelore për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike;
- Miraton planin hapësinor të Komunës. Miraton planin për shfrytëzimin e tokës, me përjashtim për zonat me dedikim të posaçëm me interes për Kosovën;
- Miraton buxhetin dhe raportin vjetor për llogarinë buxhetore;
- Rregullon dhe siguron kryerjen e veprimtarive komunale;

- Komuna është përgjegjëse për zbatimin e rregullave të Pushtetit Qendror
- Cakton shkallën e pagesave dhe tarifat për të hyrat publike në nivel komunal;
- Siguron shërbimet publike në nivel lokal, duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, sigurimin e energjisë dhe nxehjes me avull të qytetit;
- Kujdeset për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale si dhe rrugëve dhe objekteve të tjera publike me interes për Komunën;
- Rregullon dhe siguron ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve lokale të pa kategorizuara;
- Rregullon dhe siguron trafikun urban, auto-taksitë, transportin dhe vend parkingjet;
- Themelon institucionale dhe ndërmarrje (kompani) në lëmin e turizmit, arsimit, kulturës, historisë, kulturës fizike dhe sportit, të rinisë, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve;
- Ofron kushte materiale dhe teknike për rregullim, shfrytëzim racional, përparim dhe mbrojtjen e tokës ndërtimore urbanistike si dhe siguron rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirave afariste në pronësi të Komunës.
- Udhëheq dhe menaxhon pronën e Komunës;
- Disponon dhe shfrytëzon pasuritë e përgjithshme natyrore që gjenden në territorin e Komunës, përveç atyre me karakter nacional;
- Siguron, organizon dhe rregullon shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Propozon planin e zhvillimit të mbrojtjes parësore shëndetësore, politiken sociale, shërbimin social dhe strehimin, mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetit publik;
- Rregullon dhe organizon në bashkëpunim me Departamentin përkatës, mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare, shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- Jep (lëshon) lejet për shërbimet komunale, duke përfshirë arkëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik, gjuetinë, peshkimin, restorantet, hotelet, panairet përmes organeve të veta;
- Emëron drejtuesit e institucioneve parashkollore, të arsimit fillor; të mesëm, të mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes së fëmijëve, entit rehabilitues, spitaleve, institucioneve kulturore, si dhe drejtues të tjerë të institucioneve me karakter të përgjithshëm.
- Cakton kundërvajtjet për shkeljen e dispozitave (akteve), të cilat i sjell Kuvendi i përkohshëm dhe organet e tij. Kuvendi i përkohshëm themelon organin për zhvillimin e procedurave për kundërvajtje të shkallës së parë.
- Zbaton drejtpërdrejt dispozitat dhe aktet tjera ligjore të Pushtetit Qendror.
- Ushtron mbikqyerje ndaj shërbimeve komunale në lëmin e rrugëve, trafikut tokësor etj.;
- Kujdeset edhe për përmbrushjen e disa nevojave të tjera të popullatës;
- Ushtron edhe punë tjera në pajtim me dispozitat e veçanta të miratuar nga Pushteti Qendror;
- Kujdeset për mbrojtje të ambientit;
- Nxjerr rregullore, të cilat i përkasin çështjeve komunale.

Kompetencat e deleguara

Neni 19

19.1 Komuna ushtron përgjegjësitë e deleguara nga Niveli Qendoror, në pajtim me dispozita ligjore, për kompetencat vijuese:

- a) shënimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendor, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

19.2 Autoritetet Qendrore të Republikës së Kosovës, sipas nevojës, mund t'i delegojnë kompetenca shtesë komunës, në pajtim me ligjin.

19.3 Kompetencat e deleguara, në të gjitha rastet mbështeten me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

IV. Buxheti dhe të hyrat e Komunës

Neni 20

20.1 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin finanziar të Komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, të cilat përgjegjësi edhe mund të barten tek drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, përjashtimisht përgjegjësive dhe kompetencave të Kuvendit të Komunës.

20.2 Drejtorët e drejtorive të Komunës do ta mbajnë kontrollin finanziar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese brenda drejtorisë të cilën e menaxhojnë, si dhe ofrojnë të gjitha të dhënat dhe informatat drejtorit Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe zyrës së auditimit të brendshëm.

Neni 21

21.1 Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit i jep këshilla financiare Kryetarit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit, përfshirë edhe vlerësimin e kostos financiare për zbatimin e rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga organet e Komunës.

Neni 22

22.1 Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të Komunës përcaktohen me dispozita ligjore si dhe akte nënligjore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

22.2 Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, paraqet propozime të rregulloreve, procedurave dhe rregullave të tjera financiare në përputhshmëri me procedurat, rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të siguruar një administrim efikas financiar brenda Komunës dhe nga personeli i Komunës.

Neni 23

23.1 Komuna mbledh të hyra vetanake në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore nga:

- a) tatimi në pronën e paluajtshme
- b) ngarkesat për shërbime komunale
- c) tarifat për shërbime administrative komunale
- d) paluajtshmëritë në pronësi të Komunës
- e) tarifat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste
- f) gjobat në trafik
- g) gjobat për shkeljen e Rregulloreve të Komunës
- h) të hyrat nga sektori i shëndetësisë
- i) të hyrat nga sektori i arsimit,
- jj) të hyrat tjera në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.

23.2 Të hyrat sipas nenit 24.1 të këtij Statuti përcaktohen dhe ndryshohen nga Kuvendi në harmoni me ligjin.

Donacionet

Neni 24

Komuna duke u bazuar në dispozitat ligjore mund të këtë të hyrat nga donatorët e brendshëm dhe donatorët e jashtëm

Neni 25

Drejtori Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit koordinon procesin e gjithëmbarshëm të buxhetit, procesin e përgatitjes së buxhetit konsultimet e brendshme dhe konsultimet me qytetarë e subjekte të tjera relevante.

Auditimi i brendshëm

Neni 26

26.1 Komuna ka obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

26.2 Komuna ka të drejtë për të themeluar një shërbim autonom të auditimit në komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Auditimi i jashtëm

Neni 27

Niveli Qendoror bën auditimin e jashtëm të komunës në baza vjetore, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të për Auditorin gjeneral të Republikës së Kosovës.

Raporti vjetor

Neni 28

28.1 Kryetari i Komunës paraqet raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal.

Raporti i prezantohet Kuvendit të Komunës për miratim deri me 30 maj të vitit vijues.

28.2 Raporti duhet të përbaj:

- të hyrat dhe të dalat e planifikura;
- realizimet, synimet e planifikura me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre;
- mënyrën dhe lartësinë e financimit të aktivitetit të caktuar;

- gjendjen financiare të Komunës në fund të vitit fiskal;
- raportin e kontrollit financier;
- përkrahjen e dhënë organizatave jo fitimprurëse;
- marrëveshjet e arritura me lagjet urbane dhe të dhënat tjera të parapara me ligj dhe me akte tjera nga lëmi i financave.

Neni 29

29.1 Në mënyrë që të përmbushen përgjegjësit për raportim të kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Politik dhe Financa duhet të ndërmerren veprimet si ne vijim:

1. Në çdo buxhet vjetor duhet të përfshihen objektivat e Komunës ne lidhje me aktivitetet, për të cilat është përgjegjëse Komuna;
- 2 objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme;
- 3 të ndërtohen mekanizmat përmes të cilave monitorohet arritja e objektivave dhe
- 4 të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes së cilave sigurohet përmbushja e tyre.

Neni 30

30.1 Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kriterje objektive.

30.2 Buxheti duhet të përbaj planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal, dhe duhet te përfshij të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe të përditshme të Komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndaj fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

30.3 Organet e Komunës kompetente, me akt të veçantë janë të obliguara të përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e furnizimit që i plotësojnë kriteret e parapara me ligj.

Miratimi i buxhetit

Neni 31

31.1 Komiteti për Politik dhe Financa është përgjegjës për propozimin e buxhetit, për formulimin dhe hulumtimin e drejimit strategjik të Komunës në të ardhmen.

31.2 Viti fiskal i Komunës fillon me një (1) janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Kryetari i Komunës i dorëzon Komitetit për Politikë dhe Financa përkatësisht Kuvendit buxhetin e Komunës për miratim, sipas Qarkores buxhetore të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Neni 32

Kuvendi e miraton buxhetin e Komunës për një vit fiskal së bashku me projektet prioritare, destinimet, përcaktimin e vlerave për kategoritë ekonomike dhe dinamikën e shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore të Komunës.

Neni 33

Kuvendi në periudhën prej 01 korrik e më së largu deri më 30 shtator të vitit fiskal e shqyrton dinamikën e realizmit të mjeteve buxhetore dhe sipas nevojës e bënë ridestinimin e mjeteve përkatëse buxhetore.

Neni 34

Raporti finansiar për vitin pararendës fiskal shqyrtohet në Kuvend më së largu deri më 31 maj të vitit vijues.

Neni 35

Të dhënat buxhetore dhe raportet financiare janë transparente dhe qytetarët e subjektet e interesuara e kanë të drejtën e qasjes pa kufizime.

Buxheti i ndërmarrjeve publike komunale

Neni 36

36.1 Ndërmarrjet komunale të cilat kryejnë shërbime publike i dorëzojnë Kuvendit të Komunës buxhetin e tyre për miratim.

Buxheti i propozuar duhet të përfshij strukturën e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më një (1) dhjetor para viti të ardhshëm fiskal.

36.2 Në rast kur një ndërmarrje ofron shërbime publike lokale për më shumë se një komunë, komuna bënë marrëveshje me komunat gjegjëse për lartësinë e tarifave dhe mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarive të asaj ndërmarrje.

V. Organizimi territorial

Neni 37

37.1 Në funksion të krijimit të kushteve dhe mekanizmave për ushtrimin e kompetencave në mënyrë më të drejtpërdrejtë, territori i Komunës organizohet në bashkësi të lagjeve urbane;

37.2 Mënyra e organizmit, përgjegjësitë dhe përkufizimi hapësinor i njësive territoriale përcaktohen me akt të veçantë të Kuvendit të Komunës

VI. Bashkëpunimi i Komunës me lagjet urbane, ndër komunal dhe bashkëpunimi me Nivelin Qendror

Neni 38

38.1 Mbi bazën e kompetencave të Nivelit Lokal, komuna siguron mjete të nevojshme financiare dhe lidhë marrëveshje me lagjet urbane me qëllim të realizmit të projekteve konkrete dhe plotësimit të nevoja të përbashkëta.

Neni 39

39.1 Me qëllim të krijimit të kushteve për investime në ekonomi dhe avancimin e vlerave kulturore, arsimore dhe sportive si dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm, komuna mbanë lidhje të drejtpërdrejta dhe bashkëpunon me qytetarë të cilët përherë apo përkohësisht janë shpërngulur nga territori i komunës në ndonjë vend tjeter të Kosovës, apo në Botën e jashtme.

Bashkëpunimi ndërkufitar i komunave.

Neni 40

40.1 Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale.

40.2 Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësive dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

40.3 Kryetari Komunës pas konsultimit me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet t'i prezantoj rekomandimet e tij tek Kuvendi i Komunës në lidhje me marrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale për mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike që ofrohen në më shumë se një komunë.

40.4 Kuvendi i Komunës mund që brenda kornizës së ligjit, të bëj marrëveshje që të bashkëpunojë dhe të formojë partneritete me kuvendet tjera komunale, ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

40.5 Kuvendi i Komunës mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

40.6 Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet komunës së Mamushës dhe komunave tjera jashtë vendit, mund të bëhet vetëm në pajtim me ligjin.

Neni 41

Në pajtim me politikat e Nivelit Qendoror, në funksion të realizmit të projekteve të ndryshme në interes të gjithë qytetarëve apo të ndonjë lokaliteti të caktuar, komuna bashkëpunon me qytete e Komuna në botën e jashtme, me organizata qeveritare dhe organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

VII. Organet e Komunës

Neni 42

42.1 Organet e komunës janë:

- 1) Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës; dhe
- 2) Kryetari i komunës është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi i Komunës

Neni 43

43.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me dispozitat ligjore, aktet nënligjore të Nivelit Qendoror, këtë Statut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

43.2 Kuvendi i Komunës ka 15 këshilltarë.

43.3 Pushteti dhe detyrat e Komunës ushtrohen nga Kuvendi i Komunës, organet ekzekutive dhe administrative të Komunës,

43.4 Të gjithë këshilltarët e Kuvendit, kanë të drejta të njëjtë dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e Kuvendit. Kuvendi i Komunës kujdeset që këto të drejta dhe mundësi të përfshihen në Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

Funkzionet e Kuvendit të Komunës

Neni 44

44.1 Kuvendi e miraton Statutin, dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm, miraton rregulloren e punës; rregulloret komunale dhe çdo akt tjeter të nevojshëm apo të duhur përfunksionim efikas të Komunës.

44.2 Çdo vendim për miratimin apo për ndryshimin e Statutit, miratohet me 2/3 e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës të pranishëm në seancën në të cilën shqyrtohet dhe votohet.

44.3 Kuvendi e miraton Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshoj atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës, aprovohet nga më shumë se gjysma e këshilltarëve që marrin pjesë dhe që votojnë në mbledhjen në të cilën propozimi shqyrtohet.

Neni 45

45.1 Kuvendi nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- e) ngritjen komiteteve dhe komisioneve të parapara me dispozita ligjore;
- f) zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryetarit të Kuvendit;
- g) nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- j) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- k) marrjen e vendimeve përtu bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- l) përgjegjësive të tjera të përcaktuara me dispozita ligjore.

Neni 46

46.1 Kuvendi mund të delegojë pushtetin për të marrë vendime një Komiteti të Kuvendit.

46.2 Kuvendi pushtetin e deleguar mund ta revokoj në çdo kohë.

46.3 Një përgjegjësi e deleguar mundë të delegohet edhe më tej brenda autoritetit të caktuar me këtë Statut.

Neni 47

47.1 Përgjegjësit që nuk delegohen sipas **nenit 45** këtij Statuti, nuk mund t'i nënshtrohet asnjë ndryshimi, plotësimi ose modifikimi, deri sa nuk ndryshohet Ligji për Vetëqeverisjen Lokale.

Mbledhja konstitutive e Kuvendit, betimi dhe deklarata solemne

Neni 48

48.1 Kuvendi i Komunës e mban mbledhjen e parë konstitutive brenda 15 ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

48.2 Rendi i ditës i mbledhjes konstitutive, përveç tjerash, përmban:

- Verifikimi i moshës së këshilltarit më të vjetër
- ngritja e Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve
- raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve
- Dhënia dhe nënshkrimi i betimit të këshilltarëve të Kuvendit
- Dhënia dhe nënshkrimi i betimit të kryetarit të Komunës
- Ngritja e Komisionit për mbikëqyrjen e votimit për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesve të Kuvendit
- Procesi për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit
- Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit
- Dhënia dhe nënshkrimi i betimit të kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit

48.3 Këshilltari më i vjetër i Kuvendit e kryeson çdo mbledhje deri sa Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet dhe e jep betimin apo deklaratën solemne.

48.4 Këshilltarët e japidh dhe nënshkruajnë betimin apo deklaratën solemne.

48.5 Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Kuvendit zgjedhen nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit.

48.6 Forma e betimit apo e deklaratës solemne është si vijon: "**Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t`i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t`i ushtroj autorizimet e mia në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Mamushës , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët".**

48.7 Forma e betimit apo e deklaratës solemne të kryetarit të Komunës është si vijon: "**Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t`i kryej detyrat e mia dhe do ti ushtroj kompetencat e mia në cilësinë e kryetarit të Komunës së Mamushës me nder, me besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët".**

48.8 Teksti i betimit për kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin e Kuvendit është i njëjtë me tekstin e betimit për kryetarin e Komunës me të vetmin ndryshim te përshkrimi i funksionit.

Neni 49

49.1 Kuvendi mblidhet sa herë që është e paraparë me Rregulloren e punës së Kuvendit, por duhet të mbajë së paku 10 (dhjetë) mbledhje brenda vitit fiskal.

49.2 Sipas nevojës, për shqyrtimin e çështjeve të natyrës së ngutshme, Kuvendi mban mbledhje urgjente.

Neni 50

50.1 Mbledhjet e Kuvendit i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

50.2 Në mungesë të kryesuesit të mbledhjet i thirr dhe i kryeson zëvendëskryesuesi i Kuvendit.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe kuorumi

Neni 51

51.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteteve të tij përbëhet nga gjysma e këshilltarëve që marrin pjesë në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

51.2 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteteve, të gjithë këshilltarët përkatësisht anëtarët duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër një propozimi.

51.3 Kuvendi dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës.

Neni 52

52.1 Të gjitha mbledhjet duhet të thirren dhe mbahen në pàjtueshmëri me Rregulloren e punës.

Kryesuesi apo zëvendëskryesuesi i cili thërrret apo kryeson mbledhjet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në gjithë veprimet e zhvilluara në Kuvend.

52.2 Vendimet e Kuvendit dhe komiteteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të votave të këshilltarëve përkatësisht anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 53

53.1 Në mbledhjen e tyre të parë të çdo viti vijues Kuvendi i Komunës dhe komitetet i caktojnë datat fikse, në të cilat planifikohet të mbahen mbledhjet e rregullta gjatë vitit përkatës

53.2 Data e mbajtjes së mbledhjeve mund të ndryshohet me vendim tjetër.

53.3 Kuvendi, sipas nevojës mban mbledhje urgjente të cilat mund të thirren në çdo kohë.

Neni 54

54.1 Mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteteve të Kuvendit janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve te informimit dhe subjekteve të tjera të interesuara, përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

54.2 Kuvendi nëpërmjet Zyrës Përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë pune para mbledhjeve të urgjente ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- i. Shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
- ii. Mediat e shkruara dhe elektronike lokale dhe
- iii. Faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Komunës

54.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vedin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës

54.4 Kryesuesi i Kuvendit, për të gjitha mbledhjet, duhet të njoftojë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta përkatësisht 3 ditë para mbajtjes së mbledhjeve urgjente dhe atë për: datën e

konvokimit të mbledhjes, kohën, vendin, rendin e propozuar të ditës dhe të dërgojë materialet për mbledhjen përkatëse.

54.5 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës

Neni 55

55.1 Çdo pjesëmarrës në mbledhje të Kuvendit dhe komiteteteve të tij, me lejen e kryesuesit të mbledhjes, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes. Me Regulloren e punës më afersisht përcaktohen përgjegjësit e kryesuesit dhe të drejtat e qytetarëve pjesëmarrës në mbledhje përkatëse.

Procesverbalı

Neni 56

56.1 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteteve mbahet procesverbalı. Prosesverbalı përmban emrat e këshilltarëve të pranishëm në mbledhje, anëtarëve dhe personave tjerë të pranishëm, rendin e ditës, esencën e diskutimeve, rezultatin numerik të votimit, çfarëdo vote që ka dhënë çdo njeri, anëtarët dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara nëse kërkohet të thirret emri i çdo këshilltari, në procesverbal të shënohet si ka votuar.

56.2 Prosesverbalet miratohen në mbledhjen e ardhshme dhe nënshkruhen nga Kryesuesi i mbledhjes.

56.3 Prosesverbalin e mbanë një shërbyes civil komunal, i caktuar nga Shefi i Personelit,
Çdo kush ka të drejtë ta shikoj procesverbalin dhe ta marrë një ekzemplar.

Neni 57

Për konfliktin i interesit të kryesuesit të Kuvendit zbatohen dispozitat e ligjit për vetëqeverisjen lokale

Konflikti i interesave të këshilltarëve

Neni 58

58.1 Këshilltari i Kuvendit apo anëtarë i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilindë çështje në të cilin ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj, ka interes personal dhe material.

58.2 Në zbatim të nenit **45 alineja 45.1** të këtij Statuti, përjashtimi nga procedurat e marrjes së vendimeve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komitetete mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose me vendim të shumicës së atij kuorumi ose me kërkesë të palës së tretë. Më për së afërmi kjo çështje do të rregullohet me Regulloren e punës së Kuvendit të Komunës.

58.3 Këshilltarët e Kuvendit nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë udhëheqëse.

Deklarata financiare

Neni 59

59.1 Çdo këshilltarë i Kuvendit të Komunës duhet t`i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare dhe obligohen të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare ,posa ato të ndodhin në regjistrin që e mbanë shefi i Personelit.

Kompetencat plotësuese të këshilltarëve të kuvendit të Komunës

Neni 60

60.1 Këshilltari i Kuvendit ka të drejtë:

- a)** Të kérkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari i Komunës , Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Shefit të Personelit të komunës apo kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen me Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës.
- b)** Të dorëzojë vërejtje me shkrim të cilat do t`i bashkëngjiten procesverbalit .
- c)** Të diskutoj, por nuk mund të votojë në mbledhjet e komitetit të Kuvendit të cilat ai ose ajo nuk është anëtar . Ai mund t`i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është në përgjegjësi të komitetit , dhe
- d)** Të kérkoj informata dhe ndihmë të arsyeshme administrative nga drejtorët e drejtorive, që është e nevojshme për punën e tij ose saj si anëtar. Nëse ai ose ajo nuk është i kënaqur me përgjigje, ai ose ajo mund ta ngritin çështjen në Kuvendin e Komunës.

Shkarkimi i këshilltarit të Kuvendit të Komunës

Neni 61

61.1 Këshilltari i Kuvendit, i cili nuk nënshkruan betimin-deklaratën solemne brenda një muaji pas zgjedhjes , pushon të jetë këshilltar.

61.2 Këshilltari i Kuvendit, i cili ka qenë i dënuar për vepër penale më 3 (tre) muaj burgim dhe është lëshuar urdhri për burgim ,pushon të jetë këshilltar.

61.3 Në rast se ndonjë këshilltar i Kuvendit nuk merr pjesë 6 (gjashtë) muaj rresht në mbledhje të Kuvendit, ose në komitetet e tij, ai ose ajo do të pushoj të jetë këshilltar përveç nëse ka munguar me arsyë të miratuar nga Kuvendi.

Trupat punuese të Kuvendit

Neni 62

62.1 Kuvendi, në kuadër të përgjegjësive nga fushëveprimtaria e vet, në funksion të efikasitetit në lëmi të caktuara për përgatitjen akteve dhe dhënien e propozimeve në çështje konkrete, ngritë trupa punuese të përhershme , trupa të tjera për të cilët konsideron se janë të nevojshëm, trupa konsultativ dhe trupa punues ad hoc.

62.2 Trupat punuese përcjellin zbatimin e politikave të Kuvendit në lëmi përkatëse, japosn vlerësimë, vërejtje, plotësimë dhe sugjerime në materialet të cilat shqyrtohen në Kuvend, përgatitin dhe propozojnë akte të nevojshme dhe iniciojnë çështje në interes për Komunën.

Trupat e përhershme

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 63

63.1 Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin.

63.2 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave , dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke i përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

63.3 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës:

- 1) Shqyrton materialet e propozuara për mbledhjet e Kuvendit të Komunës,
- 2) Për propozimin e projekt buxhetit ,
- 3) Për identifikimin dhe hartimin e programeve zhvillimore dhe strategjike të ardhshme të Komunës,
- 4) Për përcaktimin e formave dhe mënyrave të organizimit për të hyrat në buxhetin fiskal,
- 5) për politiken e investimeve dhe harxhimeve nga mjetet buxhetore,
- 6) monitoron raportet e auditorit të përgjithshëm,
- 7) monitoron bashkëpunimin ndër komunal.

63.4 Kuvendi i Komunës mund t`i delegoj edhe përgjegjësi tjera nga fushëveprimi i tij Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 64

64.1 Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, emërohen nga radha e këshilltarëve të Kuvendit. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin e Komunës.

64.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

64.3 Komitetit për Politikë dhe Financa përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve.

Komiteti për Komuniteteve

Neni 65

65.1 Anëtarët e Komitetit për Komuniteteve emërohen nga Kuvendi në konsultim dhe në bazë të propozimeve të përfaqësuesve të komuniteteve. Anëtarët e komitetit të komuniteteve, përfshijnë këshilltarë të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësues të komuniteteve.

65.2 Çdo komunitet që jeton në komunë, do të përfaqësohet së paku me nga një (1) anëtar. Komuniteti shumicë në Komunë do të ketë më pak se gjysmën e numrit të anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve, dhe pjesa tjetër e anëtarëve të komuniteteve në Komunë, do të pasqyrojë përafërsisht numrin e komuniteteve tjera.

65.3 Kuvendi gjatë themelimit të Komitetit për Komuniteteve, duhet të sigurojë se është zbatuar procedura për emërimin e anëtarëve të këtij komiteti.

Neni 66

66.1 Komiteti për Komunitete, kryen funksionin e tij dhe ka për detyrë të sigurojë që:

- a) asnë person i cili merr detyra publike ose mban post publik, nuk guxon të bëjë diskriminim në kurfarë baze, ndaj asnë personi tjeter për shkak të përkatësisë etnike, gjuhës ose lidhjes me komunitetin.
- b) Të gjithë qytetarët të gjelqinë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabartë për punësim në shërbimet komunale në të gjitha nivelet dhe
- c) Që shërbimi komunal civil të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

66.2 Komiteti i Komuniteteve do të përkrahë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë brenda komunës, përkrah një shoqëri ku traditat e ndryshme kulturore, shoqërore dhe fetare tolerohen, por edhe do të inkurajohen dhe do të shqyrtoj drejtë çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe çështjen me rekomandimin përkatës do t'ia paraqet për shqyrtim Kuvendin.

Neni 67

67.1 Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i çdo komiteti zgjedhet nga radhët e anëtarëve të Komitetit përkatës, përveç Komitetit për Politikë dhe Financa ku kryesuesi është Kryesuesi Kuvendit të Komunës sipas funksionit

Komititetet tjera

Neni 68

68.1 Kuvendi i Komunës themelon edhe komitetet tjera:

- Komiteten për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Komiteten për Arsim dhe Kulturë;
- Komiteten për Zhvillim Ekonomik;
- Komiteten për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 69

69.1 Përcjell kujdesin shëndetësor primar dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal kujdesin shëndetësor sekondar, për stabilimentet që lidhen me ujin e pijes, kanalizimin, trajtimin e ujërave, grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave, si dhe përkrahjen për shërbime sociale dhe banimin.

69.2 Këshillon Kuvendin komunal në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe mbikëqyrë punën e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në çështjet që lidhen me politikat shëndetësore e sociale në Komunë dhe vë në rekomandime në pajtim me ligjet në fuqi.

Komiteti për Arsim dhe Kulturë

Neni 70

70.1 Përcjell fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe kopshtet e fëmijëve, themelimin dhe operimin e institucioneve mësimore, punësimin

stafit mësimdhënës, themelimin dhe operimin e objekteve në fushën e sportit dhe kulturës, si dhe organizimin e ngjarjeve kulturore dhe sportive.

70.2 Ky komitet monitoron punën e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës si dhe bënë rekomandime me ligjet në fuqi.

Komiteti për zhvillim ekonomik

Neni 71

71.1 Përcjell fushat që kanë të bëjnë me përkrahjen e zhvillimit ekonomik të Komunës, përfshirë këtu organizimin e panaireve të tregtisë dhe tregjeve, tërheqjen e bizneseve dhe turizmit si dhe për bashkëpunimin e bizneseve në nivelin lokal.

71.2 Ky komitet mbikëqyrë punën e Drejtorisë së Financave Ekonomisë dhe Zhvillimit si dhe bënë rekomandime me ligjet në fuqi.

Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 72

72.1 Përcjell planet hapësinore të përgjithshme e specifike për zonat urbane dhe rurale, përfshirë këtu çështjet që lidhen me banimin, ndërtesat publike, turizmin, mbrojtjen e mjedisit, zonat për shfrytëzim publik sikur që janë parqet, fushat e gjelbërtë dhe hapësirat rekreative, sheshet e lojërave si dhe transporti publik.

72.2 Ky komitet ndihmon Kuvendin Komunal në hartimin dhe miratimin e Rregulloreve për këto fusha: lëvizjet e trafikut, parkingjet, ndërtimet, lëshimi i lejeve ndërtimore, standardeet e mirëmbajtjes, rrugët komunale dhe vendkalimet për këmbësor, identifikimin e veçorive të interesit natyror, historik e mjedisor, përfshirë këtu mbrojtjen e tyre, emërtimin e rrugëve komunale dhe vendeve tjera publike.

72.3 Ky komitet monitoron punën e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe politikat mjedisore në Komunë si dhe bënë rekomandimin në përputhje me ligjet në fuqi.

72.4 Për themelimin e seclit komitet duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në Kuvendin e Komunës.

Komititetet konsultative

Neni 73

73.1 Komitetet Konsultative themelohen nga Kuvendi pas propozimit të marr nga kryetari i komunës, nga komitetet e përhershme në komunë dhe nga grupe i qytetarëve.

73.2 Anëtarësimi në komite të konsultative bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët njëherit duhet të jenë njohës të fushave përkatëse. Njohës i asaj fushe apo anëtar organizatës e cila merret me atë fushë veprimtari.

73.3 Kuvendi shpall konkurs publik për anëtarësimin në komitetin përkatës duke përcaktuar kriteret për konkurrim / anëtarësim.

73.4 Kandidati për anëtar duhet të jetë qytetar i komunës,

73.5 Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë në kuotën e 30%, duke përfshirë pjesëtarë e popullsisë jo shumicë, në proporcion të përfaqësimin të tyre në komunë.

73.6 Kuvendi ngritë Kolegjin për intervistimin e kandidatëve i cili duhet të ketë në përbërje anëtarë të Kuvendit dhe shoqërisë civile, i cili do t'i propozojë Kuvendit të Komunës listën me anëtarët për Komitetin Konsultativ.

Komisionet ad hoc

Neni 74

74.1 Kuvendi për shqyrtimin e çështjeve të caktuara mund të ngritë edhe Komisione ad hoc,

74.2 Mandati i Komisioneve ad hoc pushon pas zgjidhjes së çështjes.

Neni 75

Kuvendi, në kuadër të kompetencave miraton Rregulloren për përgjegjësitë dhe fushë veprimtarinë e komiteteve.

Kompensimi i anëtarëve të Kuvendit

Neni 76

Kompensimi për këshilltarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarët e komiteteve për punën që ata e bëjnë për komunën duhet të mos tejkalojë rregullat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 77

Lartësia e kompensimit të këshilltarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të komiteteve përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit.

Zyra e komuniteteve

Neni 78

78.1 Zyra e komunitetet është pjesë integrale e komunës dhe e strukturës së përbashkët administrative të cilën e themelon komuna.

78.2 Shefi i zyrës së komunitetit është sipas funksionit paraqet raportin për secilën mbledhje të Komitetit për Komuniteteve, duke përshkuar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjëse.

78.3 Zyra e komunitetit është përgjegjës për pëmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit dhe sigurimin e shërbimeve të barabarta publike në nivelin komunal.

VIII. Ekzekutivi i komunës – Kryetari i Komunës

Neni 79

Kryetari i Komunës zgjedhet me mandat katër vjeçar, mandat të njëjtë me këshilltarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 80

Kryetari i komunës është udhëheqës i Ekzekutivit të Komunës dhe zgjedhet drejtpërdrejtë nga qytetarët e Komunës me të drejtë vote.

Neni 81

Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësit e përcaktuara në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 82

82.1 Përgjegjësitë tjera të Kryetari të Komunës janë si në vijim:

- I. Mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm finansiar të Komunës;
- II. Mbikëqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovara nga Kuvendi i Komunës;
- III. Delegon përgjegjësi te drejtorët e Drejtorive dhe mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësive të deleguara;
- IV. I pròpozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e drejtorive apo drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- V. I ofron propozime Kuvendit për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- VI. Bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorive sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar;
- VII. Dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.

Neni 83

83.1 Ekzekutivi i Komunës – Kryetari, për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kuvendi i Komunës ndihmohet nga Nënkryetari i komunës (nënkryetari i komunës për komunitete), drejtorët e Drejtorive dhe Administrata Komunale.

Konflikti i interesave të kryetarit

Neni 84

84.1 Menjëherë pas zgjedhjes së tyre, kryetarët e komunave ndërpresin çdo kontratë apo lidhje që kanë, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tyre për kryerjen e përgjegjësive të tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

84.2 Kryetari i komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo finansiar.

84.3 Nga kryetari i komunës kërcohët t'i paraqesë konfliktet e interesit sa po të paraqiten ato.

84.4 Kryetari i komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

84.5 Statuti parashev masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar kryetarin nga procedurat e vendimmarrjes dhe administrative në rastet kur ka konflikt të interesit.

Nënkryetari i Komunës

Neni 85

85.1 Komuna përkatesisht Kryetari i Komunës ka një nënkryetar dhe nënënkryetarin për komunitete

85.2 Nënkyetari emërohet nga kryetari për të njëtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

85.3 Me kërkesë të kryetarit, Nënkyetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

85.4 Kur posti i nënkyetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkyetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

85.5 Neni 86 për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohet në analogji edhe për nënkyetarin.

Nënkyetari i Komunës për komunitete

Neni 86

86.1 Nënkyetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetari.

86.2 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve joshumicë.

86.3 Nënkyetari për komunitete do t'i ndihmojë kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

86.4 Kur posti i nënkyetarit për komunitete mbetet i lirë, kryetari propozon nënkyetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të paragrafit 3 të këtij nenit.

86.5 Neni 86 i këtij statute për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohet *mutatis mutandis* për nënkyetarin për komunitete.

Drejtorët e Drejtorive të administratës së Komunës

Neni 87

87.1 Administrata e komunës organizohet në drejtori.

87.2 Çdo drejtori menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari.

87.3 Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin Drejtorinë përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore, aktet nënligjore, dispozitat e këtij Statuti, Rregulloret e Komunës, si dhe udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit.

87.4 Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarjes.

Konflikti i interesit për drejtorët

Neni 88

88.1 Dispozitat e nenit 59 të LVL, do zbatohen në rast të konfliktit të interesit të kryetarit të komunës. Menjëherë pas zgjedhjes se tyre, kryetari i komunës e ndërprenë çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësive të tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

88.2 Me rregullore të punës së kuvendit të komunës, mund të parashihen masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar kryetarin nga procedurat e vendimmarrjes dhe në ato administrative në rast kur ka konflikt interesit.

88.3 Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të nenit 85 të këtij statuti për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohet mutatis mutandis për nënkyetarin për komunitete.

Shkarkimi

Neni 89

89.1 Kryetari i komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 ditëve, nëse kryetari ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

89.2. Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra të kryetarit të komunës, ministria përgjegjëse për pushtet lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e atij kryetari. Qeveria e Republikës së Kosovës (brenda 30 ditëve) mund të suspendojë me vendim kryetarin e komunës dhe t'i dorëzojë lëndën gjykatës kushtetuese.

89.3 Nëse gjykata kushtetuese e përkrah vendimin. Qeveria mund shkarkojë nga detyra kryetarin.

IX Shërbimi civil i Komunës

Neni 90

90.1 Shërbimi civil Komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të Komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 91

91.1 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

91.2 Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit, për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

91.3 Shërbimi Civil Komunal si tërsi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 92

92.1 Kryetari i Komunës në bashkëpunim me udhëheqësin e personelit do të emëroj një nën -komision , detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a)** Kategoritë dhe numrat për kategori,
- b)** Mbikëqyrja dhe përgjegjësit,
- c)** Detyrat dhe obligimet,
- d)** Delegimi i detyrave dhe obligimeve,
- e)** Rekrutimi dhe përzgjedhja,
- f)** Fushat e pranimit,

- g)** Fillimi i punës në zyrë, puna provuese,
- h)** Procedurat ankimore,
- i)** Procedurat e kundërshtimeve,
- j)** Trajnim i dhe provimet,
- k)** Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit,
- l)** Përparimi dhe suksesi në karrierë ,
- m)** Dosjet dhe referencat e stafit,
- n)** Kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punësimit,
- o)** Pagesat dhe shpërblimet tjera,
- p)** Pagesat për udhëtime dhe mëditjet,
- q)** Pushimi,
- r)** Rregullat e shërbimit civil komunal.

X Konsultimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes Tubimet me publikun

Neni 93

93.1. Komuna duhet ta konsultoj publikun në mënyrë që ta sigurojë, që vendimet e marra janë të bazuara në fakte dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve.

93.2 . Komuna po ashtu duhet të sigurojë, që qytetarët kanë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre, e që kërkesat dhe interesat e tyre janë marrë parasysh..

93.3. Qytetarët në pajtim me dispozitat ligjore, këtë Statut dhe aktet tjera nënligjore, në Komunë mund t`i shqyrtojnë çështjet me interes publik përmes :

- a).** mekanizmave të konsultimeve ,dhe
- b).** pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në tubime

Neni 94

94.1. Komuna mund të shfrytëzoj secilën formë të konsultimit të shënuara më poshtë(si dhe forma tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rr Ethanave):

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;

2. Kontaktet me grupet e interesit ,për t`i testuar dhe diskutuar politikat;

3. Anketat për zbatimin e politikës duke përfshirë informimin e klientëve dhe qytetarëve që kanë interesa;

4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregulloret, duke ftuar në pjesëmarrje me prezantime;

5. Kontaktet dhe mbledhjet me grupin e interesit;

6. Takimet publike:

7. Dëgjimet publike;

8. Studimet për vlerësim të efektit.

94.2. Kryetari, të gjitha komitetet e Kuvendit drejtorët dhe drejtorët e Drejtorive , kanë autoritet të mbajnë konsulta publike, për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.

94.3. Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun, duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e caktuar për përgatitjen e prezantimeve.

94.4 Rezultatet e konsultimeve merren parasysh dhe bëhen publike para se të merret vendimi.

Neni 95

- 95.1.** Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta dhe të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lëshuar përgjigjet.
- 95.2.** Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe t'i adaptoj format komunikuese në mënyrë që t'i përbashë synimet e audiencës, pa përashtuar mjetet tjera të komunikimit .
- 95.3.** Konsultat e hapura për publikun të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

Neni 96

- 96.1** Në pajtim me dispozitat e nenit 68 pika 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna duhet të organizoj tubime publike periodike me qytetarë, së paku dy (2) herë brenda vitit kalendarik , si formë e realizimit të vetëqeverisjes lokale. Njëra prej këtyre takimeve mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa takimi tjetër mbahet në gjashtëmujorin e dytë.
- 96.2** Në tubimet publike, përfaqësuesit komunal i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
- 96.3** Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
- 96.4** Pjesëmarrësit në këto tubime mundë të marrin iniciativa, të jalin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
- 96.5** Tubimet publike mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

Neni 97

- 97.1** Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallët së paku 14 ditë para mbajtjes së takimit. Informimi shpallët në mjetet e informimit publik , në tabelën e shpalljeve në ndërtesen e Komunës, dhe në vendet ma frekuentuese në qytet, fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.
- 97.2** Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

Neni 98

- 98.1** Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson **kryetari i Komunës (konsultim meqë duhet të jetë kryesuesi i Kuvendit)**, apo përfaqësuesi i tij.
- 98.2** Kryetari ka autoritetin të caktojë rendin e punës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë që t'i ndërpres diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësit dhe pushtetin e Komunës, pas vërejtjes së dhënë. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjoj diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
- 98.3** Nëse shtrohet ndonjë pyetje në takim publik e që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, parashtruesi ka të drejtë të kérkoj përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së tubimit.

Neni 99

- 99.1** Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimi ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna në seancë.
- 99.2** Prosesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit , e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bënë

rekomandimet e nevojshme, të cilat i`a propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e ardhshëm.

99.3 Procesverbal i publikohet në veb-faqen zyrtare të Komunës.

Peticionet

Neni 100

100.1 Në pajtim me nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin e Komunës secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t`i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidhen çështje të rëndësishme për qytetin, fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane..

100.2 Subjektet e përmendura më lartë mund t`i drejtojnë peticionin Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pà kufizuar, e që kanë të bëjnë me:

- a) rregullimin e qytetit;
- b) mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës;
- c) urbanizmin e qytetit;
- d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
- e) implementimin e vetëkontrollit ,
- ë) usurpimin e pronës,dhe
- f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

100.3 Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit , me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes Kryetarit të Komunës.

100.4 Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komisionin e pérhershëm.

100.5 Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 5000 qytetar të regjistruar në listën e votuesve , e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin. duhet ta shqyrtoj çështjen Kuvendi i Komunës, Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatrat apo me lagjet caktuara peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës nëse atë e nënshkruajnë shumica e qytetarëve me të drejtë vote.

100.6 Çdo peticion duhet të përbaj emrin, mbiemrin nënshkrimin e parashtruesit dhe nënshkruesve, adresën e parashtrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të shprehet qartë. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Neni 101

101.1 Kryetari i Komunës , në afat prej 30 ditësh, nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm ia prezanton Kuvendit të Komunës .

Kuvendi i Komunës mund të ia referojë për shqyrtim të më tejmë komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit me rastin e shqyrimit të peticionit..

101.2 Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës , në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe duhet t`i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.

Referendumi

Neni 102

102.1 Për disa çështje me interes të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me kompetencat e Komunës, për të cilat Kuvendi Komunës për arsyen e ndryshme nuk merr vendim përfundimtar, atëherë organizon referendum.

102.2 Referendumi mund të organizohet dhe të shpallet për territorin e Komunës ose për disa lagje. Vendimin për shpalljen e referendumit e miraton Kuvendi Komunës me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

Neni 103

Referendumi mund të shpallet në afat prej më së paku 6 (gjashtë) muajsh nga mbajtja e Referendumit paraprak.

Neni 104

Rezultatet e referendumit publikohen në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së tij. Referendumi është i suksesshëm në qoftë se për çështjen e kërkuar votojnë "për" propozimin, më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në regjistrin civil, në mjeshterin ku organizohet referendumi.

X. Transparenca

Neni 105

105.1 Shefi i personelit do të vë në dispozicion të publikut tërë materialin publik, ku përshkruhen detyrat dhe kompetencat e komunës, organizimi i brendshëm dhe mënyra se si publiku mund të shfrytëzoj shërbimet që ju ofrohen.

105.2 Të gjitha shkresat dhe kumtesat zyrtare që i lëshon komuna do të kenë logon dhe vulën e saj, emrin, mbiemrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që i ka lëshuar dhe që mundë të ofrojë informata ma të hollësishme lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 106

106.1 Çdo person mund të ketë qasje në dokumentet e komunës në pajtim me ligjin në fuqi mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

106.2 Personi që ka qasje në dokumentin zyrtar do të ketë mundësi ta bëjë një kopje të dokumentit për nevojat e tij, që nuk tejkalon çmimin e kopjes.

Neni 107

Nëse një person dëshmon se dokumenti të cilin e lëshon komuna përmban informata të gabueshme, ka të drejtë të kërkojë që ato informata të përmirësohen falas.

XI. Gjuhët

Neni 108

108.1 Anëtarët e bashkësive kombëtare kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhen e tyre me të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civil të komunës.

108.2 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, dhe të komiteteve të tij si dhe të gjitha tubimet publike, mbahen në të dy gjuhët: turke, shqipe dhe serbisht.

Në rast se është e nevojshme aktet dhe procesverbalet duhet të përkthehen në gjuhen e komunitetit që nuk paraqet shumicë.

108.3 Mbledhjet duhet të zhvillohen në gjuhët zyrtare të parapara me nenin 7 të këtij statuti.

XII. Miratimi, interpretimi dhe ndryshimi i Statutit

Neni 109

109.1 Statuti miratohet me 2/3 të votave të këshilltarëve pas vënies në diskutim publik përkatësisht përfundimit të procesit të diskutimit publik.

Interpretimin autentik të Statutit e bënë Kuvendi.

109.2 Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhem në mënyrën e paraparë përmiratimin e Statutit.

XIII. Dispozitat përfundimtare

Neni 110

Në rast se ekziston mospërputhje në mes të dispozitave të Statutit dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, vlejnë dispozitat ligjore.

Neni 111

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnë të gjitha dispozitat e akteve të mëparshme të Komunës në pjesët ku janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 112

Pas miratimit të këtij Statuti, në afatin prej tre muajve, harmonizohen të gjitha aktet e Komunës në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 113

Ky Statut hynë në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 001/2008

Dt. 01.12.2008

Kryetari i Kuvendit të Komunës

Arif Bütüç

